

KOMUNA E GJILANIT



PROFILI EKONOMIK 2026

Korrik '2026

Komuna e Gjilanit, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në orientimet strategjike për zhvillim ekonomik lokal, ka hartuar Profilin Ekonomik të Komunës si dokument promovues dhe zhvillimor me fokus në tërheqjen e investimeve vendore, investimeve të huaja direkte dhe fuqizimin e partneriteteve ekonomike me diasporën.

Ky profil ekonomik është konceptuar si një platformë moderne informuese dhe promovuese, e cila prezanton potencialin ekonomik, resurset strategjike dhe mundësitë konkrete për investim në territorin e Komunës së Gjilanit. Dokumenti synon të rrisë konkurrueshmërinë lokale, të promovojë klimën e favorshme për biznes dhe të krijojë ura bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe diasporës shqiptare.

Profili Ekonomik paraqet sektorët me potencial më të madh zhvillimor dhe identifikon mundësitë konkrete për investime në infrastrukturë, prodhim, shërbime dhe ekonomi digjitale.

Profili Ekonomik i Komunës së Gjilanit përfshin këto elemente kyçe:

- Ekonomia lokale – analizën e strukturës ekonomike të komunës, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, potencialin industrial, zonat ekonomike, kapacitetet prodhuese dhe mundësitë për zgjerim të investimeve private;
- Bujqësia dhe zhvillimi rural – potencialin e tokave bujqësore, zhvillimin e agro-biznesit,
- Infrastruktura dhe shërbimet publike – zhvillimin e rrjetit rrugor, infrastrukturës energjetike dhe digjitale, shërbimeve komunale, arsimit profesional, shëndetësisë dhe kapaciteteve njerëzore si faktor kyç për investime të qëndrueshme;
- Turizmi dhe sektorët inovativë – promovimin e potencialeve turistike, trashëgimisë kulturore,
- Diaspora si partner strategjik zhvillimor – Komuna e Gjilanit e konsideron diasporën jo më vetëm si kontribuues në konsum dhe remitanca, por si investitor strategjik dhe partner afatgjatë në zhvillimin ekonomik lokal.
- Partneritetet publiko-private dhe investimet strategjike – komuna synon të shfrytëzojë mekanizmat ligjorë për realizimin e projekteve zhvillimore përmes Partneritetit Publiko-Privat
- Shfrytëzimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik – bazuar në legjislacionin në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Komuna e Gjilanit ofron mundësi për investitorët vendorë dhe ndërkombëtarë që të zhvillojnë projekte prodhuese dhe zhvillimore përmes dhënies së tokës komunale në shfrytëzim afatgjatë, në funksion të rritjes ekonomike.
- Mbrojtja e investimeve të huaja – Republika e Kosovës ofron një kornizë ligjore të favorshme dhe garanci institucionale për mbrojtjen e investimeve të huaja, duke siguruar trajtim të barabartë për investitorët, siguri juridike dhe mbrojtje të kapitalit sipas standardeve ndërkombëtare.

Komuna e Gjilanit mbetet e përkushtuar në ndërtimin e një ekonomie konkurruese dhe të qëndrueshme, duke krijuar kushte të favorshme për investime, inovacion dhe zhvillim të sektorit privat.

Përmes këtij profili ekonomik synohet pozicionimi i Gjilanit si një qendër rajonale atraktive për investime, prodhim dhe zhvillim ekonomik në Kosovë dhe më gjerë.

REZULTATET E PROFILIT EKONOMIK

Profili Ekonomik i Komunës së Gjilanit paraqet një dokument strategjik që pasqyron potencialin zhvillimor, kapacitetet ekonomike dhe avantazhet konkurruese të komunës. Ai synon të promovojë Gjilanin si një destinacion të besueshëm për investime, të fuqizojë sektorin privat dhe të orientojë politikat lokale drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe afatgjatë.

Ky dokument është hartuar në përputhje me politikat kombëtare dhe lokale të zhvillimit, duke u mbështetur në:

- Programin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030;
- Strategjinë e Zhvillimit Socio-Ekonomik Lokal të Komunës së Gjilanit;
- Planin Zhvillimor Komunal (PZHK);
- dokumentet e tjera strategjike dhe legjislacionin në fuqi që rregullojnë zhvillimin ekonomik lokal.

Një nga prioritetet strategjike të Komunës së Gjilanit është zhvillimi i **Zonës Ekonomike**, e planifikuar në një sipërfaqe prej 200 **hektarësh**, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike.

Fakti që e gjithë sipërfaqja është në pronësi komunale eliminon kostot e shpronësimit dhe krijon një avantazh të rëndësishëm konkurrues, duke e bërë Gjilanin një destinacion atraktiv për investitorët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në të njëjtën kohë, Komuna ka ndërtuar një model funksional të mbështetjes së investimeve përmes vënies në shfrytëzim të pronës komunale, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Ky mekanizëm u mundëson investitorëve realizimin e projekteve afatgjata, duke krijuar siguri juridike dhe kushte të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike.

Në tërësi, Profili Ekonomik konfirmon se Komuna e Gjilanit disponon potenciale të konsiderueshme zhvillimore, një bazë të konsoliduar biznesi, pozicion të favorshëm gjeografik, infrastrukturë në zhvillim dhe politika aktive për mbështetjen e investimeve. Këto elemente e pozicionojnë Gjilanin si një nga qendrat më premtuese për zhvillim ekonomik, ndërmarrësi dhe investime në Republikën e Kosovës, duke krijuar themele të qëndrueshme për rritje ekonomike, punësim dhe mirëqenie për qytetarët.

FJALIA E KRYETARIT TË KOMUNËS



Të nderuar qytetarë, bizneset vendore, bashkatdhetarë dhe investitorë

Kam kënaqësinë që përmes këtij Profili Ekonomik të prezantoj potencialin zhvillimor të Komunës së Gjilanit dhe vizionin tonë për një ekonomi moderne, të qëndrueshme dhe konkurruese.

Gjilani sot po hyn në një etapë të re zhvillimi ekonomik, duke krijuar kushte konkrete për investime, zhvillim të sektorit privat dhe hapje të vendeve të reja të punës.

Komuna e Gjilanit po kalon nëpër një fazë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, duke krijuar mundësi të reja për investime, punësim dhe bashkëpunim afatgjatë. Përkushtimi ynë institucional mbetet i fokusuar në ndërtimin e një ambienti të favorshëm për biznes, inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe diaspora jonë, e cila përmes investimeve dhe kontributit të saj të çmuar ka ndihmuar vazhdimisht në zhvillimin ekonomik të komunës sonë. Potenciali i diasporës është i paçmuar dhe ne jemi të përkushtuar për të krijuar kushte sa më të favorshme për tërheqjen e investimeve dhe forcimin e bashkëpunimit me bizneset tona në diasporë.

Gjithashtu, dua të theksoj mbështetjen e fuqishme të komunitetit ndërkombëtar dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përpjekjet tona për zhvillim ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Komuna e Gjilanit mbetet e përkushtuar në mbështetjen e bizneseve ekzistuese dhe në krijimin e një mjedisi të favorshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë sonë lokale. Investimet e reja, veçanërisht në sektorin e industrisë së lehtë dhe teknologjisë, po krijojnë mundësi të reja punësimi dhe po kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik.

Ne besojmë se përmes bashkëpunimit, transparencës dhe përkushtimit të përbashkët mund të ndërtojmë një të ardhme më të zhvilluar dhe më të begatë për të gjithë qytetarët tanë.

Ftoj investitorët vendorë dhe ndërkombëtarë që të bëhen pjesë e këtij zhvillimi, duke shfrytëzuar mundësitë reale që ofron Gjilani për investim, rritje dhe partneritet afatgjatë.

Ju falënderoj për besimin dhe mbështetjen tuaj, me bindjen se së bashku do të arrijmë suksese të reja.

I juaji,
Alban Hyseni
Kryetar i Komunës së Gjilanit



map : Komuna e Gjilanit

MISIONI

Misioni i Profilit Ekonomik të Komunës së Gjilanit është krijimi i një mjedisi modern, konkurrues dhe të qëndrueshëm për zhvillim ekonomik, investime strategjike dhe rritje afatgjatë të mirëqenies së qytetarëve.

Komuna e Gjilanit, nën udhëheqjen e Kryetarit z. Alban Hyseni dhe përmes angazhimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ka avancuar procese të rëndësishme zhvillimore me synim transformimin ekonomik dhe krijimin e një klime të favorshme për investime vendore dhe ndërkombëtare.

Gjilani, si qendër rajonale dhe komunë ndërkufitare që kufizohet me Bujanocin dhe Preshevën (Luginën e Preshevës), si dhe me Maqedoninë e Veriut (Likovën dhe Kumanovën), ka një pozitë strategjike në raport me korridoret ndërkombëtare 8 dhe 10, duke krijuar kushte të favorshme për zhvillim ekonomik, rritje të tregtisë dhe forcim të bashkëpunimit ndërkufitar.

Ky profil ekonomik përfaqëson vizionin institucional për një Gjilan më të zhvilluar, më inovativ dhe më konkurrues në nivel rajonal. Synimi ynë është ndërtimi i parakushteve të forta për tërheqjen e investimeve të reja, zhvillimin e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të qëndrueshme të punës.

Në qendër të këtij misioni qëndron Zona Ekonomike e Gjilanit, si instrument kyç për mbështetjen e investimeve private dhe zhvillimin e kapaciteteve prodhuese, teknologjike dhe logjistike. Me një sipërfaqe prej 146.5 hektarësh në pronësi komunale, kjo zonë paraqet potencial të lartë për zhvillim industrial dhe ekonomik modern.

Misioni përfshin:

- përmirësimin e infrastrukturës ekonomike dhe publike;
- promovimin e investimeve dhe partneriteteve publiko-private;
- mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe fuqisë punëtore profesionale;
- fuqizimin e inovacionit, teknologjisë dhe sipërmarrjes;
- shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve lokale;
- forcimin e lidhjeve ekonomike me diasporën shqiptare.

Komuna e Gjilanit e konsideron diasporën partner strategjik zhvillimor, jo vetëm si burim remitancash, por edhe si investitor, ekspertizë dhe urë bashkëpunimi afatgjatë.

Përmes këtij profili ekonomik synohet pozicionimi i Gjilanit si qendër rajonale dhe ndërkufitare atraktive për investime, prodhim, inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë dhe më gjerë.

DEMOGRAFIA E KOMUNËS SË GJILANIT

Gjilani është qendër e mirëfilltë e regionit të Anamoravës, popullsia e Komunës së Gjilanit, përherë ka qenë e përzier, me dominimin e shqiptarëve gjatë të gjitha sundimeve | jetojnë këto komunitete: Shqiptarë, Serbë, Turq, Romë dhe të tjerë.

Viti 2011 - sipas regjistrimit prill 2011

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është prodhuesja kryesore e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës, përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave, si dhe koordinatorë e Sistemit Statistikor të Kosovës.

Komuna e Gjilanit në bazë të regjistrimit të fundit të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka këtë strukturë të popullsisë

Banesat	Ekonomit familjare	Gjithsejtë	Meshkuj	Femra
23,186	17,048	90,178	45,354	44 824
Të dhënat tjera				
Gjithsejë numri i banoreve		Qyteti	Zonat rurale	
90,178		54,239	35,939	

Komuna e Gjilanit ka një moshë të re ku rreth 37% përbëhet nga mosha 0-19, po ashtu vlen të ceket se rreth 27.5% e përbëjnë moshën nga 15-29 vjeç që konsiderohet një potencial i mirë.

Viti 2024 - sipas regjistrimit të fundit prill 2024

Kosova nisi regjistrimin e popullsisë më 5 prill 2024, zyrtarisht me date 25 maj 2024 ka përfunduar procesi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave | Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ende nuk e ka bërë publikimin e të dhënave të fundit |

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), sipas rezultatit preliminar të publikuar | Komuna e Gjilanit është komuna katërt më e madhe në vend, me **82,901** banorë, mosha mestarë **34.82** vjet.

FSHATRAT VENDBANIME SIPAS ZONAVE KADASTRLE

Komuna e Gjilanit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës, me një sipërfaqe prej 515 km/ ², deri në vitin 2010 kur me procesin e decentralizimit i merren 123 km/ ², Komuna e Gjilanit tani ka 392 km/ ²

- | | |
|------------------------|-------------------|
| 1. Bilinicë | 22. Kmetoc |
| 2. Bresalc | 23. Kravaricë |
| 3. Bukovik-Caparë | 24. Lipovicë |
| 4. Burincë | 25. Llovçë |
| 5. Velekincë | 26. Goden i Vogël |
| 6. Lladovë | 27. Malishevë |
| 7. Llashticë | 28. Muçibabë |
| 8. Vrapçiq | 29. Nasalë |
| 9. Verbicë | 30. Pidiq |
| 10. Gadish | 31. Pogragjë |
| 11. Gjilan | 32. Ponesh |
| 12. Sllakovc i Epërm | 33. Përlepnicë |
| 13. Livoq i Epërm | 34. Sllubicë |
| 14. Sllakovc i Ultë | 35. Stançiq |
| 15. Livoq i Ultë | 36. Stublinë |
| 16. Dunav | 37. Uglarë |
| 17. Zhegoc | 38. Cërrnicë |
| 18. Verbicë e Zhegocit | 39. Çelik |
| 19. Zhegër | 40. Shillovë |
| 20. Inatoc | 41. Shurdhan |
| 21. Kishnapolë | 42. Dobërqan |

SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

Gjilani daton nga viti 1772 dhe është themeluar nga familja e Gjinajve, e cila që nga viti 1737 ka sunduar një pjesë të Kosovës. Sulltani ka njohur pushtetin e kësaj familje.

Gjinajt erdhën në Gjilan nga qyteti mesjetar i Artanës (Novobërdë), si themelues njihet Bahti Beg Gjinolli.

Gjilani është qendër e mirëfilltë e regjionit të Anamoravës, e cila bashkë me komunat pranë saj, Vitinë, Kllokotin, Parteshin, Novo Brdën, Kamenicën e Ranillukun, por edhe me Preshevën dhe Bujanocin (Kosova Lindore) e tani më afër edhe me Likovën dhe Kumanovën (Maqedonin e Veriut) përbejnë një komunitet prej rreth gjysmë milioni banorësh.

Map | Harta Kosova dhe Regjioni i Gjilanit




Atraktive këtë regjion e bënë Lumi Morava e Binçës buron në Malet e Karadakut në territorin e Maqedonisë në jug të Vitisë e në veri të Shkupit. Dy rrjedha formojnë Përroin e Madh, i cili kur të kalon kufirin njihet si Morava e Binçes | emrin e ka marr nga vendbanimi Binçë.

Lumi Morava e Binçës rrjedh nëpër fushën e Anamoravës nëpër Lladovë, Velekincë, Pisjan, Uglar, Pogradjë e deri te Dobërçani (Mireshti), e deri në ngushticën e Konçulit kalon në Luginën e Preshevës ku pas 49 km gjatësi i bashkohet Morava e Vogël e Preshevës në afërsi të Bujanocit.

Morava e Binçës i takon pellgut të Detit të Zi. Bashkohet me Moravën Perëndimore të cilat bashkohen dhe derdhen në Danub e pastaj në Detin e Zi.

Komuna e Gjilanit është njëra nga komunat që me se shumti është prek nga procesi i decentralizimit në vitin 2010.

Nga viti 2010, Komuna e Gjilanit kufizohet : në juglindje me Preshevën (33km) dhe Kumanovën (malet e Karadakut), në lindje me Bujanovcin (40.5km), në verilindje Kamenicën (29km), në jug ka Vitinë (20km), në perëndim Lipjanin dhe Prishtinën (47km) në verilindje me Novobërdën,(19.5km)



Map | Sot, Regjioni i Gjilanit!

Pozita gjeografike e Gjilanit mundëson lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, duke qenë edhe një qendër e rëndësishme në trekëndëshin Gjilan-Preshevë-Kumanovë.

- **Lidhja e Komunës së Gjilanit me territorin e Serbisë bëhet përmes :**
 - Rugës magjistrale Gjilan – Bujanoc - Vranjë nëpër grykën e Konqulit | lidhja me autostradën Beograd – Shkup
 - Lidhja tjetër e komunës sonë me Serbinë bëhet përmes rrugës regjionale Gjilan-Pasjan – Muçibab – Preshevë dhe del në magjistralen Preshevë – Shkup .
- **Lidhja e Komunës së Gjilanit me territorin e Maqedonisë së Veriut bëhet përmes :**
 - Lidhja tjetër e komunës sonë me Maqedoninë e Veriut (Likovën dhe Kumanovën) bëhet përmes rrugës regjionale Gjilan- Zhegër – Stançiq – Kumanovë dhe del në magjistralen Beograd – Athinë | korridori 8 dhe 10



Map | Kosova dhe Korridoret Paneuropiane 8 dhe 10

Tani po punohet me te madhe | **Autostrada R 7.1 / A3** është një autostradë e gjatë 45.9 kilometra në Kosovë që është në ndërtim e sipër | kjo krijon lidhje me kryeqytetin e Kosovës (Prishtinën) nëpërmjet Gjilanit me pikën kufitare Dheu i Bardhë në kufi me Serbinë | si do qoftë, kjo autostradë ka një gjatësi totale prej 47.1 kilometra dhe do të lidhë do të lidhë korridorin 6, 7 dhe 10 | pjesë e në rrjetit TEN-T (Rrjeti Trans-Evropian i Transportit) | infrastruktura e Ballkanit Perëndimor që është pjesë integrale e korridoreve evropiane | që është me rëndësi strategjike.

Këto korridore krijojnë qarkullim të lehtë dhe i shpejtë i njerëzve dhe mallrave në masë të madhe do ta bëjë ndryshimin e ritmit të zhvillimit ekonomik, shoqëror e të gjithmbarshëm të vendeve tona.

Rrugët magjistrale dhe autostradat te rëndësisë se veçantë ne qarkullimin e lire te mallrave dhe njerëzve qe lidhin Komunën e Gjilanit me qendrat tjera dhe shtet tjera e ato janë :

Nr.	Emërtimi i rrugëve	Gjatësia
01.	Rruga Gjilan – Muqibabë – Preshevë (Serbi) dalja ne korridorin 10	33 km
02.	Autostrada Gjilan - Kamenicë – Bujanovc (Serbi) dalja ne korridorin 10	40.5 km
03.	Rruga Gjilan- Zhegër – Stançiq – Kumanovë (Maqedoni) dalja ne korridorin 8	35 km
04.	Rruga Gjilan – Partesh – Viti – Ferizaj dalja ne autostradën R6 korridorin 8 e 10	32 km
05.	Rruga Gjilan - Prishtinë – Aeroport dalja ne autostradën R7 korridorin 8	60 km
06.	Rruga Gjilan - Novobërdën	19.5 km



Foto | Autostrada R6 “Arbër Xhaferi “ dhe lidhja me Korridoret Paneuropiane 8 dhe 10

Hekurudha

Komuna e Gjilanit nuk ka hekurudhë, stacioni më i afërt i trenave është në Ferizaj 33 km larg, kjo nuk e pengon zhvillimin e komunës nga se rruga magjistrale Gjilan – Ferizaj ofron kushte të mira të transportimit të mallrave .

Aeroporti

Aeroporti më i afërt është në Prishtinë rreth 60 km larg nga Gjilani nëse shfrytëzohet magjistralla Gjilan – Prishtinë – Aeroport dhe rreth 50 km nëse shfrytëzohet magjistralla Gjilan – Lipjan – Aeroport , po ashtu ka edhe aeroportin e Shkupit 86 km.

Aeroporte Ndërkombëtar “Adem Jashari” Prishtinë

Aeroporti Ndërkombëtar i Shkupit | Maqedonia e Veriut

Aeroportet kanë lidhje dhe linja të mira me të gjitha shtet si ato në perëndim dhe në lindje, po ashtu aeroporti ndërkombëtar ofron shërbime për pasagjerë dhe shërbime Cargo.

Rrugët ujore të lundrueshme

Rrugë ujore është Deti Adriatik gjegjësisht porti i Durrësit (320 km) dhe i Shëngjinit (290 km) të cilat ofrojnë shërbime të mira nga se janë porte me ujë të thellë për bartësit e ngarkesave, po ashtu Komuna e Gjilanit është pjesë integrale e rrugës së kombit R7 Autostrada Prishtinë – Tiran – Durrës

Ujërat termo-minerale

Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (hekur e leucid) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Uglarë, Përlepnice).

Klima :

Në regionin e Gjilanit mbretëron klima e mesme kontinentale, ngase ka një lartësi relative mbidetare prej 410 m. Nuk ka erëra të forta në Fushën e Gjilanit. Rëndom frynë veriu i cili vjen nga verilindja. Kjo erë është e thatë, e ndonjëherë kur vjen me të shiu është i imët dhe i shkurtër. Kjo erë është e ftohtë, gjatë dimrit shpesh sjell borë të imtë.

Mesatarja e temperaturave vjetore për Gjilan është 10.6 °C, temperatura mesatare e muajit më të ftohtë është ajo e janarit -0,9 °C , e muajit më të ngrohtë e korrikut me 20,7 °C

Liqenet artificiale

Komuna e Gjilanit ka dy liqenin e artificiale :

Liqeni Akumulues i Përlepnices

Liqeni Akumulues i i Livoçit

Liqeni Akumulues i Përlepnices është ngritur në vitin 1966 shfrytëzohet edhe për pije edhe për ujitje të 350 hektarëve tokë të punuar. Liqeni akumulues i Përlepnices është formuar në lumin me të njëjtin emër. Vëllimi i ujit të tij është 4.2 milionë m³. Ka një sipërfaqe prej 1.634 km², dhe prurje prej 16.32 m³ ujë në sekond.

Liqeni akumulues i Livoçit, gjendet në lumin e Livoçit dhe është në afërsi të Gjilanit, është qendër e rëndësishme rekreative e banorëve të qytetit dhe e popullsisë përreth. Prapa pendës së betontë, e cila është e lartë 21 metra, është formuar një akumulacion prej 1,6 milion m³ ujë.



Foto : Liqeni akumulues i Livoçit

Organizata Promoting Private Sector Employment | PPSE & Swiss Contact), ka punuar Master planin dhe studimin e Fizibilitetit për zone turistike në liqenin e Livoçit.

Programi: Infrastrukturë e Ujit dhe Mjedisit (IUM)

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës publike është një nga prioritetet kryesore të Komunës së Gjilanit në funksion të krijimit të kushteve të qëndrueshme për zhvillim ekonomik, rritje të standardit të jetesës dhe përmirësim të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

Në këtë drejtim, Komuna e Gjilanit po përfiton nga investime të rëndësishme strategjike në sektorin e ujërave, përmes programit **FLows** – i cili synon modernizimin e plotë të sistemit të furnizimit me ujë në komunë. Projekti financohet përmes mbështetjes së Bankës Botërore dhe zbatohet në bashkëpunim me institucionet relevante.

Në kuadër të këtij programi janë duke u realizuar ndërhyrje kapitale në rrjetin e furnizimit me ujë, përfshirë instalimin e linjave magjistrale dhe primare, ndërtimin e rezervuarit të ujit të trajtuar në ITUP Përlepnica me kapacitet prej 3,500 m³, si dhe rehabilitimin dhe modernizimin e stacioneve pompuese me pajisje më efikase. Këto investime do të rrisin sigurinë e furnizimit, kapacitetin e ruajtjes së ujit dhe qëndrueshmërinë e sistemit për qytetarët dhe ekonominë lokale.



Punimet në modernizimin e infrastrukturës ujore në Gjilan po vazhdojnë me ritëm të lartë përmes programit **FLows**

✓ Janë përfunduar punimet në instalimin e linjave magjistrale në zonën urbane, ndërsa po vazhdohet puna në linjën OD 630 mm nga ITUP Përlepnica në drejtim të qytetit.

- ♦ Linja primare OD 315 mm është shumë afër përfundimit.

✂ Së shpejti do të nisë testimi dhe vendosja e kyçjeve në rrjetin sekondar, një hap i rëndësishëm drejt funksionalizimit të plotë të sistemit.

🏗 Në të njëjtën kohë, po vazhdojnë intensivisht punimet për ndërtimin e rezervuarit të ujit të trajtuar te ITUP Përlepnica, me kapacitet akumulimi prej V=3500 m³.

⚙ Paralelisht, po realizohet edhe rehabilitimi i stacioneve pompuese, përfshirë përmirësimet arkitektonike dhe zëvendësimin e pompave me pajisje me efikasitet të lartë, për furnizim më të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë.

Paralelisht me përmirësimin e furnizimit me ujë, Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me KRU “Hidromorava”, është duke avancuar projektin kapital për trajtimin e ujërave të zeza, i cili përbën një nga investimet më të rëndësishme mjedisore dhe infrastrukturore për komunën.

Ky projekt synon ndërtimin e një sistemi modern për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, duke përfshirë zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit, ndërtimin e kolektorëve dhe realizimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura.

STRUKTURA DHE FUNKSIONIMI I KOMUNËS SË GJILANIT

Statuti është akti më i lartë juridik i Komunës, i cili e rregullon organizimin e brendshëm të Komunës së Gjilanit po e përshkruajmë funksionimin e Komunës së Gjilanit.

Organet e komunës janë:


1. Kuvendi i Komunës është organ më i lartë i Komunës dhe
 2. Kryetari i Komunës është organi më i lartë ekzekutiv i komunës.
-

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë, i cili zgjidhet në mënyrë të Drejtpërdrejtë nga qytetarët (ne mandate 4 vjeçar) në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka 35 anëtarë.

Në bazë të nenit 62.1 të LVL, administrata komunale Organizohet në Drejtori ku përfshijnë:

- 1.1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme,
- 1.2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
- 1.3. Drejtoria e Arsimit,
- 1.4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- 1.5. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- 1.6. Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim,
- 1.7. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë,
- 1.8. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- 1.9. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
- 1.10. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
- 1.11. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
- 1.12. Drejtoria e Inspeksionit.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMUNËS SË GJILANIT



Tani më llogaridhënia është shumë transparente duke i përfshirë qytetarët në mënyrë pro aktive në procesin vendimmarrës.

Qeveria Qendrore | Ministria e Financave e mbikëqyr dhe koordinon politikat dhe financat ndërmjet komunave dhe nivelit qendror për të siguruar një zhvillim të balancuar dhe efikas të vendit.

Sipas qarkores buxhetore për periudhën 2026–2028, të miratuar dhe të përcaktuar nga Ministria e Financave, janë vendosur kufijtë buxhetorë për komunat, përfshirë edhe Komunën e Gjilanit, në kuadër të planifikimit afatmesëm fiskal dhe stabilitetit financiar publik.

Tabela : Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026 – 2028)

Përshkrimet / emërtimet	2026	2027	2028
Totali €	41,928,925	44,340,057	46,402,501

Këto projeksione të përcaktuara nga Ministria e Financave reflektojnë një qasje të qëndrueshme të planifikimit fiskal dhe një trend pozitiv të rritjes së mbështetjes buxhetore për nivelin lokal, duke i mundësuar Komunës së Gjilanit vazhdimësi në realizimin e projekteve zhvillimore dhe ofrimin e shërbimeve publike më cilësore për qytetarët.

Rritja e investimeve kapitale tregon orientimin drejt projekteve zhvillimore, infrastrukturës dhe përmirësimit të shërbimeve publike. Në përgjithësi, kjo kornizë buxhetore krijon kushte të favorshme për zbatimin e politikave zhvillimore dhe tregon një trend pozitiv të avancimit ekonomik të komunës së Gjilanit.

Tabela :

Përshkrimet	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Granti i Përgjithshëm	16,408,177	17,677,278	19,100,845
Granti i Shëndetësisë	4,317,011	4,446,521	4,579,917
Granti i Arsimit	14,741,775	15,184,028	15,639,549
Te hyrat vetanake	5,821,202	6,260,365	6,290,699
Financimi i teatrove	338,259	356,864	376,491
Financimi për shërbime rezidenciale	302,500	415,000	415,000
Totali €	41,928,924	44,340,056	46,402,501

ARSIMI

Arsimi para fillor, fillor dhe i mesëm është një nga segmentet kyçe, ka pasur një rritje në investime për të siguruar që të gjitha shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm kanë infrastrukturën dhe resurset e nevojshme për të ofruar një arsim cilësor.

Komuna e Gjilanit ofron kushte të qëndrueshme dhe të zhvilluara për procesin edukativo-arsimor, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës shkollore, rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve në sistemin arsimor.

Përmes investimeve të vazhdueshme në objekte shkollore, staf profesional dhe kushte mësimore, komuna po kontribuon në krijimin e një ambienti të sigurt dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në të gjitha nivelet e arsimit.

Sipas të dhënave të paraqitura / viti shkollor 2025/2026 duke i përfshirë edhe shkollat private

- Numri total i nxënësve:
 - **Arsimi fillor: 9,662 nxënës**
 - **Arsimi i mesëm: 3,302 nxënës**
 - **Arsimi parafillor: 869 nxënës**

Në total, në komunën e Gjilanit janë 58 shkolla me rreth **13,833 nxënës**, të cilët përfshihen në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, duke reflektuar një sistem arsimor të organizuar dhe funksional.

Universiteti

Në Regjionin Lindje | Gjilan | funksionon Universiteti Publik “Kadri Zeka” i cili ofron këto programe: Bachelor dhe Master :

Regjioni Lindje | Gjilan | ka edhe Kolegjin UBT presim te filloj me programet e studimit te fakultetit apo te Shkollës e Mesme te Mjekësisë me dy drejtime : Bashkëpunëtor Profesional i Infermieri dhe Teknik i Laboratorit Mjekësor

SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

Në përgjithësi, sistemi shëndetësor dhe mirëqenia sociale në Gjilan kanë qenë në një proces të përmirësimit të vazhdueshëm. Komuna por edhe Qeveria ka bërë përpjekje për të rritur aksesin në kujdes shëndetësor dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

Numri i objekteve shëndetësore në Komunën e Gjilanit

- 1 - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)
- 12 - Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF)
- 9 – Ambulanta në Mjekësinë Familjare (AMF)

Në Komunën e Gjilanit, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) është institucioni qendror që ofron shërbime shëndetësore bazike për komunitetin lokal.

Qendrat e mjekësisë familjare janë shpesh pikat e parë të kontaktit për pacientët kur ata kanë nevojë për kujdes shëndetësor dhe shpesh përcaktojnë nëse pacientët duhet të drejtohen tek specialiste të tjerë për trajtim të mëtejshëm.

Të punësuar 244 punëtorë (mjek dhe infermier) si dhe 61 ordianca private, po ashtu kemi :

Qendrën për Shëndetin Mendor

Shtëpia për Integrim në Bashkësi

Qendrën për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës si dhe

Qendrën e Punëve Sociale

Qendrën e Kujdesit Ditor për Personat e Moshuar (ne proces)

Spitali Regjional i Gjilanit ka 522 punëtorë prej tyre 109 mjeke specialiste, 319 infermier, 94 staf mbështetës: ekonomiste, bio-inxhinier, jurist dhe punëtorë tjerë ndihmës .

Spitali Regjional i Gjilanit funksionon në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ofron shërbime shëndetësore për nivelin dytësor për popullatën e regjionit të Gjilanit.

Spitali Regjional i Gjilanit ka kapacitet prej 450 shtretërve, 17 reparte : gjinekologjia, interno, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektivë, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë - emergjenca, ORL, oftalmologjia, laborator, transfuzioni i gjakut, materniteti etj.

SHERBIMET PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURA

Infrastruktura në komunën e Gjilanit përfshin një gamë të gjerë të aspekteve të jetës së përditshme, duke përfshirë:

- rrugët,
- sistemet e ujësjellës dhe kanalizimeve,
- energjinë dhe ndriçimin publik,
- menaxhimin e mbeturinave,
- transportin ndër urban dhe urban
- telekomunikimi dhe
- mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike

Të gjitha këto janë thelbësore për funksionimin e qytetit dhe për mirëqenien e banorëve.

Rrugët dhe trotualet : Komuna e Gjilanit ka një rrjet rrugor të zhvilluar, përfshirë rrugë kryesore që lidhin qytetin me qytete të tjera të Kosovës. Për të përmirësuar qasjen në rrugë dhe për të rritur sigurinë rrugore, vazhdimisht janë duke u bërë investime në ndërtimin dhe përmirësimin e rrugëve.

Është duke u punuar ne vazhdimësi për te përmirësuar gjendjen e rrugëve, tani me nuk ka asnjë lagje duke përfshirë qytetin dhe fshatrat qe nuk është përfshirë ne asfaltimin e rrugëve/ me gjithat ende po investohet dhe punohet ne këtë drejtim

Sistemet e ujësjellës dhe kanalizimeve : është thelbësore për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetareve, me sistemin e kanalizimit të ujerave fekale është i mbuluar i gjithë territori i komunës se Gjilanit ne përjashtim viset e thella malore, me menaxhimin e rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit menaxhon Ndërmarrja Publike “Hidromorava” vlen te ceket se për momentin nuk ka fabrikë te trajtimit te ujerave te zeza, edhe pse kemi fizibilitetin për këtë projekt madhor, po ashtu vlen te ceket se po punohet me Qeverinë e Kosovës dhe Komunitetin ndërkombëtar qe ky projekti te realizohet.

Energjia dhe ndriçimi publik: furnizimin me energji dhe ndriçim publik janë thelbësore për funksionimin e qytetit. Investimet në këtë fushë përfshijnë modernizimin e infrastrukturës së energjisë dhe instalimin e sistemeve të ndriçimit publik të efektshëm dhe të qëndrueshëm.

Në komunën e Gjilanit ekzistojnë 4 TS 35/10 kv : Gjilani I deri Gilani IV dhe Lladova, 24 km lidhje kobllovice dhe 347 km lidhje ajrore me gjithsejtë 3476 shtylla elektrike dhe 271 trafo

stacione 10/0.4 kv, me gjithsejtë 57 MVA fuqi instaluese 35/10(Kv) dhe 51.5 MVA fuqi instaluese Ts 110/35 (KV).

Trafo stacioni i ri “Gjilani V” donacion i ardhur nga Qeveria e Zvicrës përfundimisht Gjilani i ka thanë : lamtumirë territ dhe ngarkesave në trafo stacione në sezonin dimëror.

Menaxhimi i mbeturinave : Deponia Regjionale ndodhet në fshatin Velekicë (5km), menaxhimin e mbeturinave e menaxhon Ndërmarrja publiko-private “Ecohigjeina” ku si aktivitet primare ka grumbullimi, bartjen dhe deponimin e mbeturinave ne komunat ku vepron | komuna e Gjilanit ka Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023 – 2027 i cili është ne përputhje me Ministrit e linjës.

Transporti urban dhe ndërurban: Komuna e Gjilanit ofron shërbime të transportit publik për banorët, duke përfshirë autobusë të rregullt që lidhin qytetin me fshatra të ndryshëm në rrethin e tij, si dhe me qytete të tjera në Kosovë. Këto shërbime janë thelbësore për të lehtësuar lëvizjen e banorëve nëpër qytet dhe përreth tij.

Linjat e autobusëve të transportit urban në komunën e Gjilanit mund të ndryshojnë në varësi të nevojave të komunitetit dhe zhvillimeve të infrastrukturës.

Komuna e Gjilanit ka Planin e Mobiliteti sa i përket transportit urban qe ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve | me gjithat nuk është funksionalizuar deri me tani.

Telekomunikimi : Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) si operatori kryesor ofron një gamë të gjerë të shërbimeve, duke përfshirë: Shërbimet postare, duke përfshirë postën standarde, postën ekspres dhe postën për bizneset.

Përveç Postës dhe Telekomit të Kosovës, në Gjilan vepron edhe operatori tjetër i rëndësishëm i telekomunikacionit dhe internetit, IPKO. IPKO ofron një gamë të gjerë të shërbimeve të telekomunikacionit dhe internetit, duke përfshirë telefonia mobile, internetin fiberoptik dhe kabllorë, shërbime televizive dhe shërbime të tjera të internetit.

Ndërmarrja Publike Lokale “ Tregu” Sh.A Gjilan është përgjegjëse për **mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike** | Ndërmarrja “Tregu” deri në fund të muajit Nëntor 2023 numëron rreth 285 punëtorë të cilët janë të angazhuar edhe ne mirëmbajtje tjera.




foto : parku "Baja" Gjiilan

Sipërfaqet e parqeve dhe hapësirave publike | Mirëmbajtja

sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike ne hektar : 12 ha

sipërfaqja e hapësirave publike komunale ne hektar : 161.04 ha

sipërfaqja e hapësirave publike qe mirëmbahen rregullisht : 9,36 ha

numri i përgjithshme i hapësirave publike : 52

numri i hapësirave publike t pajisura me ndriçim publik eshë : 39

BUJËQESIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Sektori bujqësor është gjithashtu i rëndësishëm në ekonominë e Gjilanit, me prodhim të kulturave të ndryshme bujqësore dhe bimorë.

Gjilani ka një traditë bujqësore të theksuar, bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave për shumë banorë të zonës rurale.

Bujqësia dhe zhvillimi rural janë sektorë thelbësorë për ekonominë lokale, sigurinë ushqimore dhe tërheqjen e investimeve në zonat rurale.

Mbështetja për fermerët nuk po mungon nëpërmjet teknologjisë së avancuar bujqësore, investime në pajisje dhe infrastrukturë bujqësore.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, e cila është 39 071 hektarë, 99,75% është mbulesë tokësore, ndërsa 0,25%, ose 96,5 hektarë është e mbuluar me ujë, 54,1% e tokës përbëhet nga pyje, ndërsa 45,99% është tokë bujqësore. Shumica e pyjeve (61,89%) përbëhen nga pemë halore, 38,11% nga pemë gjetherënëse.

Sipërfaqja e tokës bujqësore në shfrytëzim është 17 969 ha, ndërsa kopsht edhe sera kemi 46 ha.

Numri i ekonomive bujqësore është 4165 ferma, me grurë i kemi 2970 ha, misër 1043 ha, perime 121 ha. Me pemë frutore i kemi 294 ha, prej tyre mollë 126.80 ha, kumbull 74 ha, vishnje 46 ha, dardhë 13 ha, dredhëz 10 ha, dhe mjedër 13 ha.

Sa i përket blegtorisë, aktualisht janë të evidentuara 3874 krerë gjedhe, në 1561 ekonomi bujqësore, 9340 krerë dele në 98 ekonomi bujqësore si dhe 2225 krerë dhi në 143 ekonomi bujqësore. Gjithashtu në komunën e Gjilanit ka pula vojse rreth 234,000 copë, bletë (koshere) 3490 në 157 ekonomi bujqësore, derra rreth 1390 krerë. Po ashtu janë edhe 2 qumështore, 3 thertore 3 ambulanca veterinare dhe 1 fermë sportive.

Bujqësia dhe zhvillimi rural : si objektiv tjetër është avancimi i teknologjisë përpunuese përmes mekanizimit bujqësor duke i subvencionuar fermerët për çdo vit me mekanizëm bujqësor. Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm modern bujqësor, ndikon direkt në cilësinë e produkteve të cilat përdoren në industrinë agropërpunuese, e që i ndihmon fermerët t'i rrisin kapacitetet e tyre.

Komuna e Gjilanit ka 41 xhami dhe 8 kisha ortodokse. (burimi: përfaqësues të bashkësive fetare). Gjithsej 64 objekte të trashëgimisë kulturore (27 arkeologjike dhe 37 arkitekturore) janë përfshirë në listën e vendeve nën mbrojtje të përhershme/përkohshme të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

Komuna e Gjilanit, është e pasur me trashëgimi kulturore dhe historike që e bën atë një destinacion tërheqës për turistët.

Për nga aspekti turistik komuna e Gjilanit mund të ndahet në këto lokalitete turistike: Malet e Zhegocit; Malet e Karadakut (ose Malet e Zeza), Malet e Sllubicës, Lugu i Haxhajve të Zhegërës, Lugu i Bukovikut, Lugu i Burincës, Gryka e Llapushnicës, Shpella e Bresalcit, Shpella e Resulës, Lumi Morava e Binçës, Lumi Mirusha, Liqeni i Livoçit, Uji Mineral i Nasalës, Burimi i ujit në fshatin Pidiq, si dhe Banjat minerale: Banja e Uglarit, Banja e Mireshit, dhe Banja e Dunavit.

Muzeu Etnologjik i Gjilanit: Ky muze është një vend ku mund të studiohet historiku dhe kultura e Gjilanit dhe rajonit përreth | Trashëgimia kulturore në shërbim të zhvillimit të turizmit siç është Muzeu i Qytetit i cili ndryshe njihet si “Objekti i Kajmekamllakut” gjendet në qendër të qytetit | Shkolla e Muzikës, përballë Atik Xhamisë, ky objekt quhej Saraji i Mustafë Pashës;



Diversiteti fetar e kulturor | Komuna e Gjilanit karakterizohet me një diversitet të madh fetar dhe kulturor. Kosova si vend në përgjithësi është i njohur për këtë diversitet, pasi që përfshin një varg komunitetesh fetare dhe etnike të ndryshme.

Popullsia me shumicën u përkasin besimit mysliman, ka një pjesë të popullsisë që janë të krishterë dhe të tjerë.

Në përgjithësi, Gjilani është një shembull i mirë i harmonisë së komuniteteve fetare dhe kulturore në një mjedis urban.

Kalaja e Pogragjës, gjendet në kilometrin e 10 nga qyteti i Gjilanit, në fshatin Pogragjë, krahas kalasë është mjaft atraktive edhe Gryka e Llapushnicës; Fortifikata parahistorike në Cërnice; Kalaja e Mireshit, është monument i trashëgimisë kulturore në Miresh, Dobërçan, Kalaja e Pidiqit, është monument i trashëgimisë kulturore në Pidiq-Shurdhan, Kalaja e Përlepnice, etj. Atik Xhamia, xhamia e Cernicës, xhamia e Dobërçanit, kisha katolike „Kisha e Shën Anës” në fshatin Dunavë, tyrbet në qytet, kisha e Shën Nikollës, Sahat Kulla.

Pastaj janë Atraksionet Natyrore: Penda e Livoçit, lokaliteti Stublinë, lokaliteti Zhegoc me rrethinë, lokaliteti Stanishor me rrethinë, liqeni i Përlepnice, dhe burimet termale në Uglar dhe Dobërçan.

Në komunën e Gjilanit janë 244 ndërmarrje dhe punëtori hoteliere të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbime të fjetjes, ushqimit, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, ahengjeve familjare, banketeve, seminareve, trajnimeve dhe shërbimeve të tjera.

Kultura : Teatri i Qytetit të Gjilanit, Flaka e janarit është një festival kulturor multidimensional, i cili fillon më 11 janar Gjilan dhe me ndezjen simbolike të flakadanit, për të vazhduar deri më 31 janar me aktivitete të ndryshme kulturore.

Monumentet historike : Varrezat e Dëshmorëve është një vend i rëndësishëm historik dhe memorial i cili i kushtohet dëshmorëve të qytetit të Gjilanit që sakrifikuan jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL

Gjilani duhet të njihet për vlerat që i ka | ka ardhur koha të mendojmë parimisht por edhe krijojmë strategji të qëndrueshme, sepse bazuar në Ligjin nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë kompetenca të plota në Zhvillimin Ekonomik Lokal.

Bazuar në Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komuna ka të drejtë të japë në shfrytëzim pronën e saj të paluajtshme, me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe realizimit të interesit publik, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë të palëve.

Sipas këtij ligji, pronat komunale mund të jepen në shfrytëzim për:

- periudhë afatshkurtër nga 1 deri në 15 vite;
- periudhë afatgjatë nga 15 deri në 99 vite.

LISTA E PRONAVE TË PALUAJTSHME KOMUNALE

- Të cilat do të epën në shfrytëzim për vitin vijues për periudhë afatshkurtër (1-15 vite) dhe periudhë afatgjatë (15-99 vite)
- Me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe realizimit të interesit publik, duke e respektuar parimin e trajtimit të barabartë të palëve, Komuna e Gjilanit bazuar në Ligjin nr. nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ka hartuar listën e veçantë të pronave të paluajtshme komunale të cilat ofrohen për shfrytëzim gjatë vitit vijues.
- Në këtë listë ofrohen të dhënat kadastrale të pronave të nxjerra nga SIKTK (Sistemi i informatave kadastrale të tokave të Kosovës),

Për herë të parë, investitorët vendorë dhe ndërkombëtarë kanë në dispozicion një pasqyrë të qartë të pronave komunale që mund të shfrytëzohen për investime afatshkurtra dhe afatgjata, duke mundësuar planifikim më të mirë të projekteve dhe rritjen e sigurisë juridike gjatë procesit të investimit. Kjo qasje rrit besimin e sektorit privat dhe forcon partneritetin ndërmjet komunës dhe investitorëve.

Përmes krijimit të mundësive konkrete për investim në prona komunale, diaspora ftohet të bëhet pjesë aktive e projekteve zhvillimore, duke investuar kapitalin, përvojën profesionale dhe rrjetet ndërkombëtare që zotëron.

Ky është një mesazh i qartë se Komuna e Gjilanit synon të ndërtojë një ekonomi të bazuar në investime produktive, partneritete afatgjata dhe shfrytëzim racional të pasurisë publike.

Komuna e Gjilanit, përmes Drejtorisë së Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës, ka identifikuar 51 parcela të paluajtshme të disponueshme për investitorë vendorë dhe ndërkombëtarë, me fokus në zhvillimin ekonomik dhe interesin publik.

Struktura e parcelave sipas destinimit:

- ✓ 22 parcela për bujqësi
- ✓ 3 parcela për afarizëm dhe bujqësi
- ✓ 2 parcela për turizëm, rekreacion dhe hoteleri
- ✓ 3 parcela për blegtori dhe shpezëtari
- ✓ 2 parcela për pemtari dhe aktivitete të ngjashme
- ✓ 1 parcelë për afarizëm, sport, rekreacion dhe energji solare
- ✓ 2 parcela për pemtari
- ✓ 1 parcelë për industri dhe bujqësi
- ✓ 1 parcelë për bujqësi, turizëm dhe rekreacion
- ✓ 1 parcelë për energji të ripërtëritshme (erë dhe diell)
- ✓ 2 parcela për energji të ripërtëritshme dhe zhvillim afarist
- ✓ 4 parcela për veprimtari afariste
- ✓ 6 parcela për turizëm malor/rural dhe energji të ripërtëritshme

Në total, sipërfaqja e ofruar për investim është mbi 4 milion m², duke ofruar potencial të konsiderueshëm për projekte të qëndrueshme dhe afatgjata.

Ekonomia lokale e Gjilanit përfshin një gamë të gjerë sektorësh dhe aktiviteteve ekonomike. Disa prej sektorëve kryesorë në ekonominë e Gjilanit përfshijnë:

1. **Industria e ushqimit** : Gjilani ka një sektor të zhvilluar të prodhimit të ushqimeve, duke përfshirë prodhimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore.
2. **Industria e prodhimit të radiatorëve** : njohur si Jugoterm, fabrika e radiatorëve “Enrad” ka afro 40 vite përvojë dhe është një nga prodhuesit kryesorë të radiatorëve panel dhe gypor në Kosovë dhe në rajon.
3. **Tregtia dhe shërbimet**: Gjilani ka një aktivitet të zhvilluar tregtar dhe sektor shërbimesh, duke përfshirë biznese të ndryshme si restorante, hotele, dhe shërbime të tjera të konsumit.
4. **Industria e ndërtimit**: Ndërtimi është një sektor që ka rritur rëndësinë në vitet e fundit, me zhvillime të reja të objekteve të banimit dhe infrastrukturës.

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve

Shërbimet për regjistrimin e bizneseve në Komunën e Gjilanit ofrohen përmes Qendrës për Regjistrimin e Bizneseve, e cila funksionon në kuadër të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK). Decentralizimi i këtij shërbimi ka sjellë administratën më afër qytetarëve dhe komunitetit të biznesit, duke mundësuar që procedurat për regjistrimin e bizneseve dhe shërbimet e tjera administrative të kryhen në nivel komunal.

Qasja më e lehtë në këto shërbime ka reduktuar kohën dhe kostot administrative për ndërmarrësit, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për themelimin e bizneseve të reja dhe zhvillimin e sektorit privat. Kjo ka ndikuar pozitivisht në rritjen e aktivitetit ekonomik dhe në zgjerimin e bazës së bizneseve në komunë.

QENDRA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE - GJILAN

Skema 1 : Biznese të regjistruara 2010 - 2025

Emërtimet	Të regjistruara 2010 - 2025															
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Prodhuese	24	47	96	82	78	59	82	80	60	78	93	73	93	72	88	14
Tregtare	223	202	207	173	160	139	139	114	125	125	115	151	122	124	150	22
Shërbyese	90	223	276	272	263	276	313	230	254	269	241	270	313	385	331	43
Ndërtimore	9	41	32	34	35	45	41	49	46	41	53	45	41	32	43	5
Gjithsej	346	513	611	561	536	519	575	473	485	513	502	539	569	613	612	84
Emërtimet	Të regjistruara 2010 - 2025															
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Pronar femra	58	68	95	122	93	99	104	77	106	101	91	129	122	155	134	72
Pronar meshkuj	288	445	516	439	443	420	471	396	379	412	411	410	447	458	478	12
Gjithsej	346	513	611	561	536	519	575	473	485	513	502	539	569	613	612	84
Punëtorë	463	817	1209	956	880	837	962	824	743	910	798	850	887	1073	1060	116

Të regjistruara 2010 - 2025

Biznese Prodhuese : 1,119

Biznese Tregtare : 2,291

Biznese Shërbyese : 4,049

Biznese Ndërtimore : 592

Biznese Pronare Femra : 1,626

Biznese Pronar Meshkuj : 6,425

Gjithsej biznese të regjistruara : 8,051

Punëtorë të deklaruar : 13,385

Analiza e të dhënave tregon se sektori i shërbimeve përbën aktivitetin dominues ekonomik në komunë, i ndjekur nga sektori tregtar, ndërsa vitet e fundit evidentohet edhe një interes i vazhdueshëm për zhvillimin e veprimtarive prodhuese dhe rritjen e numrit të bizneseve në pronësi të grave. Këto tregues pasqyrojnë një bazë ekonomike dinamike dhe një klimë të favorshme për zhvillimin e ndërmarrësisë në Komunën e Gjilanit.

RËNDËSIA E VENDIMIT TË QEVERISË SË KOSOVËS PËR PARKUN INDUSTRIAL

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e Parkut Industrial në Komunën e Gjilanit, me një sipërfaqe prej rreth 200 hektarësh në Livoç të Epërm, përfaqëson një nga zhvillimet më të rëndësishme strategjike për ekonominë e komunës dhe të rajonit të Anamoravës. Ky vendim krijon bazën institucionale për transformimin e Gjilanit në një qendër moderne të prodhimit, përpunimit dhe investimeve industriale.

Parku Industrial pritet të krijojë kushte konkurruese për tërheqjen e investorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, duke ofruar hapësira të planifikuara për zhvillimin e industrisë, logistikës, teknologjisë dhe veprimtarive të tjera prodhuese. Përqendrimi i bizneseve në një zonë të dedikuar do të mundësojë zhvillim më efikas të infrastrukturës, ulje të kostove operative dhe rritje të konkurrueshmërisë së ekonomisë lokale.

Parku Industrial nuk duhet parë vetëm si një hapësirë për ndërtimin e objekteve industriale, por si një platformë strategjike për zhvillimin ekonomik të Gjilanit në dekadat e ardhshme.

Në kombinim me politikat komunale për vënien në dispozicion të pronave komunale për investime, ky vendim krijon një ekosistem të favorshëm për investime të qëndrueshme, inovacion dhe zhvillim ekonomik, duke e pozicionuar Gjilanin si një nga qendrat më perspektive për zhvillim industrial dhe afarist në Republikën e Kosovës.


Duke u bazuar në **Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës**, Komuna e Gjilanit ka dëshmuar se shfrytëzimi afatgjatë i pronës komunale është një instrument efektiv për tërheqjen e investimeve strategjike.

Një shembull i suksesshëm është vendimi i vitit 2021, kur Komuna i dha në shfrytëzim afatgjatë për **99 vjet** tokë komunale kompanisë "**Albimi LTD**", për realizimin e një investimi industrial. Në këtë lokacion po ndërtohet fabrika për dizajnimin dhe montimin e biçikletave, duke konfirmuar se politika e vënies në funksion të pronës komunale po zbatohet me sukses në terren.

Ky investim dëshmon se, kur prona publike menaxhohet në mënyrë strategjike dhe transparente, ajo shndërrohet në një nxitës të zhvillimit ekonomik, krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes së kapaciteteve prodhuese të Komunës së Gjilanit.

GJILANI - QENDËR RAJONALE

Gjilani përfaqëson një nga qendrat më të rëndësishme rajonale dhe administrative në lindje të Kosovës, falë përqendrimit të një numri të konsiderueshëm institucionesh publike dhe organizatash mbështetëse që ofrojnë shërbime për qytetin dhe komunat përreth. Prania e këtyre institucioneve ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, administrativ dhe social të rajonit, duke lehtësuar qasjen e qytetarëve dhe bizneseve në shërbime të specializuara.



Ndër institucionet kryesore me rëndësi rajonale në Gjilan bëjnë pjesë:

- Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës;
- Qendra për Aftësim Profesional;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Qendra për Zhvillim Rajonal
- Agjencia e Pyjeve të Kosovës;
- Oda Ekonomike;
- Këshilli i Bizneseve të Rajonit të Gjilanit.

Përqendrimi i këtyre institucioneve e forcon rolin e Gjilanit si qendër e rëndësishme për administrimin publik, zhvillimin e sektorit privat, mbështetjen e investimeve, nxitjen e punësimit dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe komunitetin e biznesit në nivel rajonal.

Qendrën për Aftësim Profesional (QAP Gjilan)

Nje institucion tjetër i rëndësishëm në aspektin e përgatitjes së fuqisë punëtore është edhe Qendra për Aftësim Profesional (QAP Gjilan) i cili ofron trajnime profesionale me kohëzgjatje prej 3-6 muaj në këto drejtime:

- Zdrukthtari,
- Saldues,
- Dizajn Grafik & Multimedia,
- Kontabilitet,
- Rrobaqepësi dhe
- Kuzhinieri.

QAP Gjilan është një nga mekanizmat më të rëndësishëm për komunitetin e biznesit, pasi kontribuon drejtpërdrejt në krijimin e kuadrove të kualifikuara sipas nevojave reale të tregut lokal të punës. Trajnimet janë plotësisht **falas**, duke e bërë këtë qendër një mundësi të qasshme për të rinjtë dhe qytetarët që synojnë aftësim profesional dhe punësim më të shpejtë.

Që nga viti **2023**, Komuna e Gjilanit, përmes Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ka ndërmarrë hapa konkretë për krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat dhe nxitjen e ndërmarrësisë. Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me komunitetin e biznesit, komuna ka orientuar politikat dhe mbështetjen financiare drejt iniciativave që kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Në këtë kuadër, Komuna ka krijuar **Fondin për Subvencionimin e Bizneseve Start-up dhe Bizneseve në Pronësi të Grave Ndërmarrëse**, një instrument i rëndësishëm financiar që synon të mbështesë themelimin dhe zhvillimin e bizneseve të reja, si dhe të fuqizojë rolin e grave në ndërmarrësi.

Përmes këtyre masave, Komuna e Gjilanit synon të krijojë kushte më të favorshme për tërheqjen e investimeve, zhvillimin e ndërmarrësisë, fuqizimin e sektorit privat dhe përsheptimin e zhvillimit ekonomik lokal.

KONTAKTET

Përshkrimi i institucionit	Kontakti
Kryetari i Komunës	0280 320 781
Fax	0280 320 784
Sekretaria e Kuvendit	0280 321 482
Drejtoria e Administratës	0280 324 257
Centrali	0280 326 428
Drejtoria e Financave	0280 324 219
Financat	0280 324 729
Tatimi në Pronë	0280 320 217
Drejtoria Kadastrës	0280 320 142
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	0280 320 365
Drejtoria e Shërbimeve Publike	0280 324 065
Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	0280 324 213
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	0280 320 587
Kultura, Rinia, Sporti	0280 321 725
Drejtoria e Arsimit	0280 323 458
Drejtoria e Shëndetësisë	0280 323 603
Drejtoria e Urbanizmit	0280 320 065
Sektori për Urbanizëm	0280 320 065
Sektori i Planifikimit	0280 322 686
Prokurimi	0280 326 020
Zyra për Informim	0280 321 486

Profili Ekonomik i Komunës së Gjilanit është hartuar në përputhje me modelin e miratuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shërben si një dokument informues për prezantimin e potencialeve ekonomike, investuese dhe zhvillimore të komunës.

Ky dokument synon t'u ofrojë investitorëve, partnerëve zhvillimorë, institucioneve dhe komunitetit të biznesit një pasqyrë të qartë mbi resurset, infrastrukturën, klimën e të bërit biznes dhe mundësitë për investime në Komunën e Gjilanit.

Komuna e Gjilanit mbetet e përkushtuar për të krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillimin ekonomik, mbështetjen e sektorit privat dhe tërheqjen e investimeve të reja, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet, bizneset dhe partnerët vendorë e ndërkombëtarë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.

Fadil Osmani, Zyrtar për Zhvillim Ekonomik
+383 45 218 100
Facebook : Invest in Gjilan